



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
KLINIKA STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE
TIRANË

Tiranë, me 19.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “FV APARATURA STOMATOLOGJIKE “PER
NEVOJAT TE KSU -SE, PER VITIN 2023.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

MALLRA, Kodet CVP: 38520000-6

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5 833 333 leke (pa tvsh), me burim financimi buxhet shteti
2023 (investime 231), miratuar nga MFE me shkresen nr. 16182/1, date 09.10.2023**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Klinika Stomatologjike Universitare Tirane**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, ne masen 2% te e vlerës së përlogaritur të kontratës ne nje nga format e parashikuara ne ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” konform nenit 83, vlefshmeria 150 dite.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (shtojta 8 e vetedeklarimit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. Vertetim per xhiron vjetore te tre viteve te fundit (2019, 2020 dhe 2021) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% i vleres se fondit limit, të kontrates qe prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Gjithashtu vendosja e kriterëve ne reference eshte bere që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe/ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar, me qëllim për të treguar se operatori ekonomik ka eksperiencë të suksesshme në një fushë të tillë. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per procedurën e hapur te thjeshtuar eshte percaktuar se vlere totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe permasat e kontratës, specifikimet teknike, grafikun e levrimit të mallit, gjykon që pjesë e kritereve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kritereve si vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna

te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.

- a) Operatori ekonomik duhet te paraqes nje deklarate me ane te se ciles merr persier te kryeje sherbimin e transportit deri ne adresen e AK.
- b) Operatori ekonomik duhet te paraqesi deklartara mbi origjinen e mallit (firma prodhuese dhe vendi i prodhimit).
- c) Operatori ekonomik duhet te paraqes deklarate e garancise se mallit objekt kontrate, jo me pak se 24 muaj nga data e marrjes ne dorezim.

Argumentimi: Në bazë, të nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, 8, neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit PublikOE të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si

- a) fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose
- b) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Bazuar sa me siper, AK duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Kuadri ligjor ne reference I jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Kriteret per kualifikim lidhur me autorizimin e prodhuesit duke përfshirë në mënyrë alternative edhe autorizimin nga distributori i autorizuar nga prodhuesi me kushtin që në cdo rast të vërtetohet me dokumentacion konkret lidhja e distributorit të autorizuar me prodhuesin pasi ky dokumentacion i paraqitur në mënyrë të plotë do të vërtetonte dhe dëshmonte njësoj origjinën e mallit, katalogu, mostrat, deklarata, njesia e prokurimit i gjykon se vendosja e tyre është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi dhe jodiskriminuese. Persa I perket deklarates per mjet per transportin e mallit, ky kriter kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme ose ekuivalentet e tyre per objektin e prokurimit si me poshte: Certifikatat te jene leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit te cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- **ISO 14001: 2015**, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;

Certifikata si më sipër duhet të paraqitet origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Me anën e këtij kriteri synohet që të njihet aftësia e operatorit për të ofruar punë që plotësojnë kërkesat e Autoritetit Kontraktor, si dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore sipas standardeve më të larta. Ky standart u vendos në bazë të nenit 79, pika 1 e tij, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, e nenit 40, dhe 44, pikës 3 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kriter në përputhje me natyrën e objektit të kontratës. Autoriteti kontraktor vlerëson këtë kriter si të nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratës. *Certifikimet ISO jane certifikata qe iu akordohen kompanive te cilat manifestojne menaxhim te larte bazuar ne standartet nderkombetare te vendosura ne perputhje me legjisacionin nderkombetetar qe e rregullon kete fushe, per te garantuar mallra me cilesi dhe ne perputhje me specifikimet teknike pjese e dokumentave te tenderit. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë, kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për objektin e prokurimit, që do të përfshihen në specifikimet teknike në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1,2 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik...

- 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.*
- 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që*

garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Bazuar në procesverbalin e të hartuar nga grupi i punës i ngritur për këto qëllime, ky grup në hartimin e specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të mallit, ka marrë në konsideratë faktin se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat shërbimeve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

AK në hartimin e specifikimeve teknike ka në vlerësim se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “c”, “ç”, “d” “dh” e LPP-së) janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike të hartuara ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këto kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike AK ka shmangur çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast specifikimet teknike nuk janë hartuar në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

Në hartimin e specifikimeve teknike AK ka mbajtur në vëmendje faktin se specifikimet teknike mbeshtetur në nenin 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në vijimësi, AK ka zbatuar me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike. Me anë të specifikimeve teknike mundësohet një konkurrencë e drejtë e hapur dhe gjithëpërfshirëse të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Në përfundim AK ka vendosur kritere nisur nga natyra dhe permasat e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të saj, duke përshkruar minimumin e elementëve teknikë si edhe ka vendosur termin ekuivalent në ato raste kur nuk ekziston një

mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdherin e titullarit të AK në përputhje me qëllimin e realizimit të shërbimit me qëllim arritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të këtij shërbimi, duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si vijon:

Skaner 3D

Pajisje me rreze X për të kryer imazhe panoramike dixhitale tomografike të plota ose të segmentuara dhe imazhe dixhitale tre-dimensionale me rreze-X të zonës dento-maksilofaciale për t'u përdorur në drejtimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor si mbështetje diagnostikuese për pacientët pediatrikë dhe të rritur. Pajisja duhet të jetë e pajisur me sistemin perkates Cefalometrik për të kryer imazhe imazhe cefalometrike në kohë të shpejta. Të mundesojë pozicionimin e fytyrës pa lazer.

Pajisja duhet të plotesoje të dhenat teknike si më poshtë:

Karakteristikat elektrike të pajisjes

Pajisja duhet të punojë në Tensionin e rrjetit 150-240V AC me frekuencë 50-60 Hz

Rryma e absorbuar në kushte pushimi jo më shumë se 0.5A në tensionin 240V

Rryma maksimale e pajisjes në kushte pune: jo më shumë se 12A

Rezistenca e qarkut të furnizimit me energji elektrike: 0,5 Ohm (max) me Fuqi jo më pak se 6kW, me rryme jo më shumë se 16A gjatë ekspozimit dhe Fuqia maksimale jo më pak se 2.2 kVA

Pajisja të plotesoje standartin e mbrajtjes kundër pluhurave dhe legjeve IPX0

Kushtet ambientale të përdorimit

Pajisja të punojë në temperaturë nga 10 në 35 gradë Celsius

Në lagështi ambienti nga 30 to 80 %

Karakteristikat e Gjeneratorit me Rreze-X

Tensioni Tubit: 60-90 kV me hapa +1 kV

Rryma e tubit 2-15mA me hapa +25%

Saktesia e kohës së ekspozimit: Sekonda +/- (10% + 1 ms)

Frekuenca: 140kHz

Tube focal spot: 0.7 mm

Filtrimi Total: jo me I vogel se 2.5 mm eq. Al

Tensioni I Anodes: 90 kV

Rryma e katodes : 15 mA

Pajisja te nuk duhet te kete kushte shtese per menyren e ftohjes, ftohja e pajisjes te arrihet me konvencion natyror.

Shperhapja maksimale e nxehtesise ne ajrin e ambientit jo me shume se 33W ne menyre te vazhdueshme.

Karakteristikat e Tubit me Rreze-X

Anod ate jete prej tungsteni

Tipi I Anodes: Fiksuar (jo rrotulluese)

Madhësia nominale e pikës fokale: 0.6mm

Tensioni I larte nominal: 110 KV

Fuqia nominale e Anodes: nga 1260 W to 2000 W

Sasia maksimale e nxehtesisë së akumuluar në anode: jo me shume se 30kJ

Lartësia minimale - maksimale e pikës / dyshemesë: 1090-1680 mm

Filtrimi: jo me e vogel se 2.5 mm eq. Al

Modaliteti Panoramik

E pajisur me teknologjine e sensoreve CMOS

Fusha e Imazhit 6.4 x 140 mm (per te rritur) dhe 6.4 x 120 mm (per pediatrike)

Madhesia e Pixel (μm): 100

Madhësitë përfundimtare të imazhit (piksel): "L size : 2900 x 1400

M size : 2765 x 1400

S size : 2490 x 1400

XS size : 2180 x 1200"

Rezolucioni I detektorit (Lp/mm): 5.0

Shkalla Gri: 16384 - 14 bits

Distanca midis pikës fokale dhe sensorit: 563mm

Zmadhimi: 1.2

Levizja e dedektorit gjate ekzaminimit: Eliptike e ndryshueshme

Madhesia e ekx=zaminimit: afersisht 2.5 mbyte

Ekzaminimet radiologjike: Panoramike e plote (full panoramic) panoramike me segmente (Segmented panoramic), Maxillary sinus, Lateral TMJ x 2, Lateral TMJ x 4

Metodat e ekspozimit: minimumi 4 paciente te ndryshem (Femije, te rritur me trup te vogel; te rritur me trup mesatar, te rritur me trup te madh) me te pakten 3 morfologji harku Dentar (normal, square, sharp)

Koha e ekspozimit nga 2 ne 14 sekonda

Rregullimi i lartësisë së kolonës te behet ne menyre te motorrizuar.

Modaliteti 3D

Nepermjet teknologjise se rikonstruksionit volumetric Dentar [Dental Volumetric Reconstruction (DVR)] me teknologjine e sensoreve CMOS dhe Csi coating

Fusha Volumetrike e shikimit (Volume FOV): 5 x 5 per femije (4X4) opsionale , 8 x 5 opsionale, Ontario 8 x8 opsionale

Ekzaminimet radiologjike per: Nofulla e plotë, e sipërme ose e poshtme

Molar i plotë, i sipërm ose i poshtëm; Sinusi maksilar; okluzione dhe dhembe te fokusuar.

Shkalla Gri: 16384 - 14 bits

Zmadhimi: 1.4

Madhësia minimale e vokselit pa interpolim : jo me pak se 75 µm

Madhësi të tjera Voxel në rindërtim (µm): 150 - 300

Metade e skanimit: e vazhdueshme

Koha e ekspozimit: jo me shume se 3- 15 s

Koha e rindertimit te imazhit: jo me shume se 2 minuta

Formati ekzaminimeve DICOM 3.0 me komprimim pa humbje - Kornizë e vetme me Madhesi jo me shume se 200 Mbyte

Pajisja duhet te kete te perfshire krahun Cefalometrik me modalitete si me poshte:

Me teknologjine e sensoreve CMOS

Me fushe imazhi : 6.4 x 263.3 mm

Me shkalle gri: 16384 – 14 bits

Zmadhim jo me pak se: 1.13

E afte per te kryer ekzaminime radiologjike per: Lateral; Frontal AP or PA; Oblique; Submento-vertex me opSION per Carpus me kohe ekspozimi jo me shume se: 2.9 to 11 s

Te punoje ne tensionin e rrjetit 240V AC me frekuence 50Hz

Distanca midis pikës fokale dhe sensorit: 1700mm

Madhesia e pikselit (μm):100

Rezolucioni I sistemi (Lp/mm): 5

Lëvizja e detektorit gjatë ekzaminimit te behet me skanim ne menyre horizontale

Dhe te ofroje mundesine per njohje automatike te shenjave anatomike cefalometrike dhe gjurmimi i studimit.

Karakteristikat e PC

CPU: 2,4 GHz Duo Core

RAM: 4 GB

HDD: 1.2 GB per instalimin e software dhe 250 GB te lira per perdorimin e programit

Graphic board: Nvidia/ATI based board supporting Open GL 1.2 with 512 MB of dedicated video RAM on AGP x8 video bus

CD / DVD Drive : Kerkohet te jete e e pajisur me DVD-BURNER drive

Ekрани: rezolucioni minimal 1024x768

Systemi i operimit: Windows 10 ose me lart

Backup Media: Removable/portable, external hard disk drive

Te perfshije dhe programin dhe licensen permanente per 3D dhe ekzaminimet cefalometrike.

Operatori duhet te kete certificate ISO 9001 dhe ISO 14001.

Njesi portative dentatare

Specifikimet:

- Kompresor ajri i integruar
- Turbine inkorporuar
- Aerotor+kundrange inkorporuar
- Llampe polimerizuese inkorporuar
- Scaler per gurezat inkorporuar
- Kanjule thithese inkorporuar
- Tensioni: 100-240 V
- Fuqia: 0.75 kw
- Te jete sa me e lehte
- Minimalisht e zhurmshme

Motor Kirurgjikal I kompletuar

Aparat kirurgjikal + contrangel implantar, CE

Specifikimet:

I thjeshte ne perdorim

Aparati per serumin

Irrigim i jashtem

Programe te shumefishta

Shpejtesia deri ne 2000 RPM

Kontraangli me led

Kontrolli me kembe

Pesha maksimale 4 kg

Bashkengjitur foto model.

- Konstrukt robust dhe te qendrueshem me baze te gjere dhe me kembeza me gomine qe te mos rreshqase dhe te siguroje stabilitetin maksimal.

- Fuqia 500W

- Voltazh 220V

- Frekuenca 50-60vHz

Vend te posacem per vendosjen e mikromotorit dhe pjesamenin e tij.

Bashkengjitur model.



Grupi i punës për përlogaritjen e fondit limit, pas finalizimit të nevojave/ specifikimit teknik të hartuara bazuar në nenet 34 dhe 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 12, 13 76 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, filloj punën për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës objekt prokurimi, konkretisht si vijon:

Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Lidhur me këtë proces, grupi i punës ka argumentuar dhe dokumentuar referuar materialeve , administruar si pjese e dosjes se prokurimit.

Pas hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit dhe kritereve për kualifikim Njësia e prokurimit, në zbatim të pikës 3, të manualit teknik “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike*”, miratuar me udhëzimin nr. 07, datë 30.7.2021 të APP, autorizoi znj. V.V për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për procedurën e prokurimit per objektin ne reference si dhe në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, vendosi si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave: 31.10.2023, ora 10:00 www.app.gov.al

Njësia e Hartimit të Dokumentave Standarde